

Organizata e Marketingut në Prespë për Prodhimet e Zonës

Krijimi i një Organizate Marketingu (OM) për produktet e disa grupe prodhuesish të përzgjedhur në Parkun Kombëtar të Prespës në Shqipëri.

Konteksti

Parku Kombëtar i Prespës është një zonë kufitare e rëndësishme dhe me potenciale të mëdha për turizëm, bujqësi dhe një rang të gjerë produktesh përfshirë mjaltin, peshkun dhe bimët medicinale. Gjithësesi, prodhuesit e kësaj zone përballen me sfida lidhur me marketingun dhe shitjen e produkteve të tyre. Kjo e nxiti Ministrinë e Mjedisit të ngrrejë një projekt në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Urbane (IKU) të financuar nga KfW për zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e biodiversitetit në këtë zonë.

Qëllimi: Marketing më i mirë

Popullsia vendase brenda dhe rreth Parkut Kombëtar të Prespës do të përfitonte shumë nga rritja e kanaleve të shitjes, identifikimi i tregjeve të reja dhe përmirësimi i marketingut për produktet e tyre. Qëllimi kryesor i projektit është të përmirësojë cilësinë e jetesës dhe të sigurojë mundësi të reja për zhvillimin ekonomik për grupet prodhuese dhe popullsinë vendase në zonën e Prespës. Rezultatet që priten pas ndërhyrjes sonë janë:

- Një Organizatë Marketingu (OM) plotësisht vepruese që i shërben nevojave të grupeve prodhuese në Prespë
- Kapacitete të përmirësuara të grupeve prodhuese për të kryer marketing dhe shitje të suksesshme

IKU është përgjegjës për zhvillimin e një plan biznesi dhe strukturës organizative të OM. Trajnimet mbi marketingun, ndërtimi i kapaciteteve dhe vendosja e standarteve të cilësisë do të jenë pjesë e paketës së punës të IKU-t.



Çertifikata e Origjinës

Një nga detyrat kryesore të projektit është të sigurojë një standart të ri dhe një markë për anëtarët e Organizatës së Marketingut. Pas diskutimeve me Ministrinë e Mjedisit është rënë dakord që një Çertifikatë e Origjinës do të sigurojë njohjen dhe fuqinë e markës për produktet e Prespës. Marka e Organizatës si dhe e produkteve specifike do të përfshijë etiketimin dhe paketimin. Për marketingun e vetë organizatës hapja e një faqe në Facebook dhe pjesëmarrja në panairë do të jenë pjesë e aktiviteteve promovuese.

Synohet Qëndrueshmëria

Qasja e projektit konsiston në regjistrimin e grupeve të prodhuesve dhe prodhuesve individualë në Organizatën e Marketingut me qëllim për të krijuar volume më të mëdha, cilësi më të lartë dhe markë të unifikuar. Ndërsa shitjet dhe të ardhurat fillojnë të rriten dhe bëhen të qëndrueshme, anëtarët do të inkurajohen që të paguajnë tarifa të vazhdueshme për stafin e korporatës dhe veprimet e përbashkëta.

FAKTET KRYESORE

PARTNERËT:

- ✓ Ministria e Mjedisit
- ✓ KfW
- ✓ Administrata e Parkut Kombëtar të Prespës

KOHËZGJATIA:

Korrik 2014-Qershor 2015

PËRFITUESIT:

- ✓ Bletërritësit
- ✓ Shoqata e Peshkimit
- ✓ Prodhuesit dhe koleksionistët e Bimëve Medicinale
- ✓ Koleksionues të produkteve të egra natyrore

REZULTATET E PRITSHME:

- ✓ Grupe prodhuesish të organizuar për marketing më të mirë.
- ✓ Kapacitete për të zhvilluar marketingun dhe zgjerimin e shitjeve.

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë

Tel: +355 4 2256840

E-mail: zvokopola@uri.org.al

Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur /Fondacioni Soros, etj.